



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM
Nr. 512, Datë 17.05.2018

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në ‘Tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës’”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.05.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e hetimit paraprak në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agro-ushqimore në qytetin e Tiranës.

Bazë ligjore: Neni 9, neni 24 shkronja d dhe neni 42, pika 1, i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin në ‘tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës’”;

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 28, germa a, të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, në datën 02.05.2018, realizoi monitorimin në tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, me qëllim evidentimin nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, në shkelje të nenit 9 të ligjit 9121/2003, i ndryshuar.

Ky treg administrohet nga shoqëria EKMA Albania Shpk, dhe është i vetmi treg i madh në qytetin e Tiranës që është furnizues edhe i pikave të pakicës për këto produkte. Në këtë treg janë të grumbulluar tregtarët e pikave të shumicës që shesin edhe me pakicë

produktet agro-ushqimore por edhe produkte të tjera të konsumit të përditshëm. Shoqëria që menaxhon agro-ushqimor e përcakton vetë ambientin dhe nuk i jep mundësi tregtarit që të zgjedhë.

Gjithashtu në treg nga monitorimi rezultoi se disa tregtar ushtronin aktivitet në kamionë në ambientet e jashtme të këtij tregu, për arsye se nuk i kanë dhënë ambiente me qira. Për këto arsye kjo shoqëri mund të vendos në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthorte çmime të padrejta të blerjes ose shitjes ose kushte të padrejta të tregtimit që mund të bien ndesh me nenit 9 të ligjit 9121/2003.

Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjes që administrojnë tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24 shkronja d, dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në “Tregun e qiradhënies të ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”.
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore nga 1.1.2017 deri në 1.5.2018.
- III. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 1 (një) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS